

SHTOJCA 3b

Datë: 27/10/2025

**TERMA REFERENCE**

Subjekti	BePro shpk – Projekti NEXORA
Objekti i prokurimit:	Zhvillimi i Modulit të Menaxhimit të Udhëtimit dhe Akomodimit
Buxheti maksimal (lekë, me TVSH):	730,988
Data e nisjes së prokurimit:	15/11/2025
Data e mbylljes së prokurimit:	30/11/2025

**1. Përmbledhje**

Ky dokument përcakton kërkesat teknike dhe funksionale për zhvillimin e modulit të menaxhimit të udhëtimit dhe akomodimit për platformën NEXORA. Moduli do të ndihmojë koordinimin e mbërritjes së klientëve, akomodimin dhe transportin.

**2. Qëllimi i Kontratës**

Qëllimi i kësaj kontrate është ndërtimi i një modul funksional të zhvilluar mbi teknologjitë Symfony (back-end), MySQL (databazë) dhe Angular 15+ (front-end), me funksionalitete të dedikuara për menaxhimin e klientëve i integrueshëm me platformën ekzistuese.

**3. Përshkrimi i Shërbimit**

Subjekti i kontraktuar do të realizojë detyrat e mëposhtme:

- Ndërtimi i strukturës së të dhënave për udhëtimet
- Krijimi i formave të regjistrimit dhe menaxhimit të udhëtimeve
- Ndërtimi i panelit për hotelet
- Ndërtimi i panelit për shoferët
- Implementimi i roleve të përdoruesve

- Ngarkimi i dokumenteve
- Testim dhe dorëzim i modulit

### Dorëzimet (Deliverables)

Nr.	Dorëzimi	Përshkrimi	Afati i Dorëzimit
1	Moduli i udhëtimit	Zhvillimi i nderfaqes ku agjentet do të hedhin të gjitha informacionet mbi udhëtimin	Deri më 30/12/2025
2	Paneli i hoteleve	Paneli ku hospitaliteti do të shikoj të gjitha kërkesat për rezervim si dhe do të caktoj dhomat për klientet	Deri më 30/12/2025
3	Paneli i shoferëve	Nderfaqe e cila do të lejojë shoferet të shikojnë planin e dites si dhe të raportojnë për taskt të kryera në kohë reale	Deri më 30/12/2025
4	Role dhe autorizime	Krijimi i permission dinamike që do të lejojë ndërthurje të roleve nga administratorët	Deri më 30/12/2025
5	Kodi final dhe dokumentim minimal	Kodi burim si dhe dokumentimi i modulit.	Deri më 30/12/2025

## 4. Kohëzgjatja e Kontratës

Kontrata do të zgjasë 30 ditë kalendarike nga nënshkrimi dhe pritet të përfundojë deri më 30/12/2025.

## 5. Kriteret e Përzgjedhjes dhe Vlerësimit

### Kriteret Teknike

- Eksperiencë bazë në zhvillim web
- Referenca ose projekte të ngjashme
- Kapacitet për dorëzim brenda afatit

### Kriteret Financiare

Fiton vetëm oferta me çmimin më të ulët që përputhet me specifikimet teknike

## 6. Vlera e Kontratës dhe Pagesat

- **Fondi limit:** 730,988 LEK (me TVSH).
- Nëse fituesi është individ, do të aplikohet **tatimi mbi të ardhurat (15%)** sipas ligjit në fuqi.

## 7. Dorëzimi i Ofertave

Subjektet e interesuara për të marrë pjesë në këtë procedurë duhet të dorëzojë dokumentacionin e mëposhtëm, në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktues:

### 7.1.1 Për subjekt fizik/juridik

Nëse oferta paraqitet nga një subjekt fizik ose subjekt juridik, duhet të dorëzohen dokumentet e mëposhtme:

- Ekstrakt nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB).
- Profili i kompanisë

### 7.1.2 Për individë (ekspertë të pavarur)

Nëse oferta paraqitet nga një individ si ekspert i pavarur, duhet të dorëzohen dokumentet e mëposhtme:

- CV e detajuar ku të evidentohet eksperiencia përfshirë arsimimin, eksperiencën profesionale, projektet e mëparshme dhe certifikimet përkatëse.
- Diploma universitare.

### 7.2 Dokumente Financiare

- Ofertën financiare për çdo produkt sipas tabelës më sipër.

- Ofertën teknike te zgjidhjes së ofruar

### *7.3 Afati dhe Mënyra e Dorëzimit*

- Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen **brenda datës 30/10/2025**
- Dokumentet duhet të dorëzohet me email, te gjitha dokumentat e kërkuara duhet te jenë brenda një skedari zip
- Adresa e Dorëzimit do të jetë email i dedikuar për projektin [nexora@bepro.al](mailto:nexora@bepro.al)
- Çdo aplikim i dorëzuar pas afatit të përcaktuar nuk do të merret në shqyrtim.

### *7.4 Verifikimi dhe Kualifikimi*

- Dokumentet e dorëzuara do të verifikohen nga autoriteti kontraktues për përputhshmëri me kërkesat e kësaj ftese për ofertë.
- Vetëm subjektet që dorëzojnë **një dokumentacion të plotë dhe të vlefshëm** do të konsiderohen të kualifikuar për fazën e vlerësimit të ofertave.
- Nëse dokumentet janë të paplota ose nuk përmbushin kriteret ligjore, subjekti do të skualifikohet nga procedura.

### *7.5 Kriteret e skualifikimit*

Subjekti do të s'kualifikohet nga procedura nëse:

- Nuk dorëzon një ose më shumë nga dokumentet e kërkuara brenda afatit të përcaktuar.
- Nuk përmbush kushtet ligjore dhe financiare për të ofruar shërbimet.
- Ka paraqitur informacion të pavërtetë ose të pasaktë në dokumentacionin e tij.
- Nuk dëshmon eksperiencën e kërkuar në projekte të ngjashme.